

# RAPORT PER AUDITIMIN E RAPORTIT VJETOR FINANCIAR TË PARTISË BASHKIMI PËR TE DREJTAT E NJERIUT

Për Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve

## I. INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM

### A. INFORMACIONI LIGJOR

#### i. Kuadri ligjor

Kuadri ligjor referohet dhe në kontratën e shërbimit të auditimit ligjor të raporteve vjetore financiare të partive politike sipas ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar dhe procesi i realizimit të tij bazohet në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar, ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", legjislationin e fushës fiskale, si dhe në aktet nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim.

#### ii. Standartet e kontabilitetit të zbatueshme

Në përputhje me ligjin, Nr.25/2018, datë 10.05.2018, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", partitë politike kanë statusin e njësive jofitimprurëse dhe janë objekt i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të) dhe specifikisht i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jo Fitimprurëse (SKK për OJF-të).

### B. OBJEKTI I AUDITIMIT

#### i. Kontrata e shërbimit

Për përmbushjen e misionit të auditimit, me palën angazhuese KQZ-në, u lidh kontrata e shërbimit me nr 1466/1 datë 26.04.2019, me objekt: "Kryerja e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2018, nga partitë politike në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, aktet nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", se dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre".

Por përveç kontratës së mësipërme, në datën 13.05.2019 është lidhur dhe kontrata me partinë politike me qëllim që të dokumentojë dhe konfirmojë pranimin dhe kushtet të angazhimit, si palë përgjegjëse e raportimeve financiare që do të auditohen.

KQZ  
U PROTOKOLLUA  
NR/2001 PROT  
DATE 21 06 2019

## ii. Vendimi i KQZ-së

Në përputhje me kuadrin rregullator të përzgjedhjes dhe emërimit të ekspertëve kontabël të licencuar për auditimin e partive politike, KQZ-ja me vendimin nr.112 datë 27.03.2019 na ka emeruar si auditues të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut.

## iii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor

### Përgjegjësitë e drejtimit të partisë

Auditimi ynë do të kryhet bazuar në faktin që drejtimi (personi përgjegjës për financat në partinë politike ose personi i përcaktuar sipas statutit të partisë), të pranojnë dhe kuptojnë se kanë përgjegjësi:

- a) Për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare (raportit vjetor) në pajtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat jo-Fitimpruese (SKK për OJF-të) dhe me kërkesat specifike të ligjit "Për Partitë Politike" i ndryshuar, dhe në udhëzimet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ-së);
- b) Për kontrollet e brendshme të atilla që drejtimi partisë i konsideron të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomalitë materiale nga mashtrimi apo gabimi; dhe
- c) T'i japin audituesit:
  - Të drejtën e hyrjes në të gjitha informacionet për të cilat drejtimi ka dijeni se janë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare, siç janë regjistrimet, dokumentacioni dhe çështje të tjera;
  - Informacion shtesë, të cilin audituesi mund ta kërkojë nga drejtimi për qëllime të auditimit; dhe
  - Të drejtën e komunikimit pa kufizim me personat brenda partisë nga të cilët audituesi e gjykon të nevojshme për të marrë evidencë auditimi.

Si pjesë përbërëse e procesit të auditimit, ne kërkojmë nga drejtimi i partisë kur është e përshtatshme, edhe nga personat e ngarkuar me administrimin që të marrim prej tyre konfirmime me shkrim lidhur me deklaratimet me gojë që do të na bëhen në lidhje me auditimin.

### Përgjegjësitë e audituesit

Auditimin do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike. Si pjesë e një auditimi sipas SNA-ve, ne do të ushtrojmë gjykimin profesional dhe do të mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Si rrjedhojë e kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, së bashku me kufizimet e vetvetishme të kontrollit të brendshëm, ekziston një rrezik i pashmangshëm që disa nga anomalitë materiale të mbeten të pazbuluara, edhe pse auditimi është planifikuar siç duhet dhe kryer në përputhje me SNA-të.

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare (raporti vjetor financiar) në tërësi nuk kanë anomalitë materiale, për shkak mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomalitë materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen

materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet e përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

### **C. INFORMACION MBI SUBJEKTIN POLITIK**

#### **i. Prezantimi i subjektit politik**

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut është themeluar në shkurt të vitit 1992, vazhdimisht ka qenë e përfaqësuar në Kuvendin e Shqipërisë dhe në të gjitha nivelet e pushtetit lokal. Ajo është parti e organizuar dhe e strukturuar si në aspektin administrativ ashtu edhe në atë politik-statusor. PBDNJ ka 33 dege në mbare vendin edhe rreth 7800 anetar. PBDNJ ka lidhje të drejtperdrejte me Organizatën e Gruas, Forumit Rinor dhe shoqatën e minoritetit Grek "Omonia".

#### **ii. Forma e organizimit dhe menaxhimittë partisë**

Në zyrat e saj qendrore, në administratë punojnë sekretari, financiar dhe pastruesja (part-time). Struktura politiko-statusore e Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut përfshinë:

Qendren:

- Kryetari
- Këshilli Drejtues
- Kryesia
- Sekretaret

Deget

- Kryetar Dege
- Këshilli
- Kryesia
- Anetaret

### **D. PREZANTIMI I RAPORTIT VJETOR DHE STRUKTURA E TIJ**

#### **i. Struktura e raportit- kërkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet.**

Struktura e raportit vjetor financiar (Pasqyrat financiare) të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, të publikuara në KQZ-ë, përbëhen pasqyra e performancës (pasqyra e aktiviteteve).

#### **ii. Takimet dhe komunikimet midis audituesit dhe subjektit zgjedhor dhe çdo personi tjetër të tretë.**

Menjëherë pas firmosjes së kontratës me KQZ-në, në datën 26.04.2019 u vendosën kontaktet me personelin që merret me administrimin e partisë. Në takim me Kryetarin e Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, zotin Vangjel Dule me datë 21.05.2019, nënshkrua kontrata në të cilën u përcaktuan termet e angazhimit dhe përgjegjësitë reciproke të palëve.

Në vijim u bashkëpunua në vazhdimësi me personelin që merret me çështjet ekonomike dhe të shërbimit kontabel, z. Olgert Thomallari, prej të cilëve siguroam raportin vjetor financiar për vitin 2018, dokumentacionin kontabel, regjistrimet dhe informacione të tjera që lidhen me auditimin tonë.

- iii. **Paraqitje e përgjithshme e raportit vjetor të partisë politike (nëse është ose jo në përputhje me kërkesat e raportimit).**

Ne vlerësuam paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e raportit vjetor (pasqyrave financiare), përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, të publikuar për vitin 2018 nga PBDNJ-ja, nëse ato paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrën që të japin paraqitjen e drejtë.

Raporti vjetor financiar, i paraqitur dhe publikuar në KQZ-ë, është hartuar sipas SKK-ve, por nga pikpamja e formës është përgatitur sipas setit të pasqyrave financiare që aplikohen për organizatat fitimprurëse dhe jo sipas formës së pasqyrave të kërkuara prej SKK-së për OJF-të, siç përshkruhet në pikën "Standartet e kontabilitetit të zbatueshme" të këtij raporti.

Por gjithashtu, drejtimi i partisë i ka përgatitur dhe riparaqitur të njëjtin informacion ekonomik dhe financiar dhe në setin e pasqyrave financiare sipas kërkesave të SKK-së për OJF-të, të cilat na u dorëzuan gjatë procesit të auditimit dhe që i bashkangjiten raportit.

## II. KËRKESAT FORMALE TË RAPORTIT VJETOR

### A. PËRMBLEDHJE

<b>1. Data e dorëzimit të raportit vjetor</b>			
	Dorëzimi fizik	Po	Datë, 04.02.2019
<b>2. Nënshkrimi</b>			
	Nënshkrimi	Po	Datë, 04.02.2019
	Identiteti i nënshkruesit	Po	Emri Vangjel Dule-Kryetari Partisë Olqert Thomallari-Financier

### B. INFORMACION MBI PARTIN, AUDITUESIN DHE LOGARITE BANKARE

<b>1. Informacioni për parti të politike</b>	
Emri i partisë politike	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut
Adresa e selisë qendrore	Bulevardi Barjam Curri, Nr 32, Tirane
Numri i telefonit të selisë qendrore	042377921
Adresa e e-mailit të selisë qendrore të partisë (nëse ka)	contact@pbdnj.com
<b>2. Informacion për audituesin ligjor</b>	
Emri i audituesit ligjor të caktuar	Eleda Dhima
Adresa e audituesit ligjor	Lagja Xhevdet Nepravishta, Rr. Vasil Prifti, Godine 1 kateshe, perballe shkolles "Foto Puka", Lushn
Numri i telefonit të audituesit ligjor	0694098121
Adresa e e-mailit të audituesit ligjor (nëse ka)	eledadh@yahoo.it

3. Të dhënat e llogarisë bankare të partisë politike	
Emri i bankës ku mbahet llogaria	Alpha Bank
Adresa e zyrës së bankës ku mbahet llogaria	Bulevardi Zogu I, Nr. 47, Tirane,
Numri i telefonit të zyrës së bankës	042271668
Adresa e e-mailit të zyrës së bankës apo zyrtarit përgjegjës të bankës.	
Numri i llogarisë bankare	902020125000044006
Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar për veprimet tek llogaria bankare	Vangjel Dule, Olgert Thomallari

### C. AKTIVET DHE DETYRIMET

1. Kriteret e klasifikimit të aktiveve	
<p><u>Përshkrimi natyrës së secilit aktiv, pronë e partisë, në datën e vlerësimit</u></p> <p>Sipas natyrës, aktivet në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, 31.12.2018 përbëhen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mjete monetare në arkë dhe ë bankë</li> <li>- Aktive afatëgjata materiale, te luejtëshme si, automjete, mobilje zyre, paisje kompjuterike dhe inventar ekonomik.</li> </ul>	
<p><u>Përshkrimi i vendndodhjen e aktivit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendndodhja e aktiveve materiale eshte prane selisë qendrore, ne adresen e përshkruar me lart.</li> <li>- Nuk ka aktive të administruara nga degët e partisë ne qarqe dhe bashki, pasi ne to nuk ka zyra dhe detyra administrimi.</li> </ul>	
<p><u>Vlerat e tregut të aktivit, në datën e vlerësimit nëse është bërë vlerësim, ose vlerën kontabël të mbetur.</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mjete monetare në arkë dhe ë bankë 31.12.2018.  Llogaria bankare pranë Alpha..... 16,820 lekë  Mjete monetare ne arkë..... 1,025 lekë  Shuma mjete monetare 6,762,147 lekë</li> <li>- Aktive afatëgjata materiale  Aktive afatëgjata materiale, me koston e blerjes dhe të krijimit..... 0 lekë  Amortizimi i akumuluar..... 0 lekë  Aktive afatëgjata materiale neto..... 0 lekë</li> </ul>	
2. Kriteret e klasifikimit të detyrimeve	
<p><u>Përshkrimi i llojit të secilit detyrim të partisë, në datën e vlerësimit</u></p> <p>Sipas llojit, detyrimet në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, 31.12.2018 përbëhen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nuk ka detyrime.</li> </ul> <p>Te pagueshme total 0 lekë</p>	
<p><u>Vlera e detyrimit në datën e vlerësimit dhe kushtet e shlyerjeve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nuk ka asnje detyrim</li> </ul>	

## D. PËRMBLEDHJE FINANCIARE

Përmbledhje Financiare	
Periudha e raportimit (data e parë dhe e fundit e periudhës që mbulon raportin).	01 Janar 2018-31 Dhjetor 2018
Shuma e parave në arkë në fillim dhe në fund të periudhës së raportimit (data e parë dhe e fundit e periudhës që mbulon raportin).	Gjendja e arkës 01.01.2018.....2,619,242 lekë Gjendja e arkës 31.12.2018.....17,845 lekë
Shuma e përgjithshme e të gjithë kontributeve të marra.	Të ardhura gjithsej .....0 lekë
Shuma e përgjithshme e të gjitha shpenzimeve të bëra.	Shpenzime gjithsej.....2,601,397 lekë
Bilanci në fund të periudhës së raportimit (data e fundit që mbulon periudhën).	31 Dhjetor 2018
Shuma e përgjithshme e të gjithë aktiveve në fund të periudhës së raportimit.	Aktiv 31.12.2018.....17,845 lekë
Shuma e përgjithshme e të gjithë detyrimeve në fund të periudhës së raportimit.	Detyrime 31.12.2018.....0 lekë

### a.Vlerësimi i informacionit dokumentar mbi llogaritë bankare

Nga evidenca dokumentare që morëm nga drejtimi i partisë rezultoi se PR ka hapur llogari bankare në monedhen "Lekë" pranë Alpha Bank.

Për të gjitha llogaritë bankare kemi marrë levizjet e llogarive bankare (bank statement) për të gjithë vitin financiar nga 1 janari 2018 deri në 31 Dhjetor 2018.

Nga auditimi rezultoi se transaksionet janë regjistruar, klasifikuar dhe raportuar në mënyrë të rregullt dhe nuk u kostatuan gabime apo mosperputhje me kërkesat rregullatore.

Për vitin 2018 nuk janë evidentuar dhurime nga fonde jopublike dhe nuk janë hapur llogari të posaçme siç kërkohej nga ligji "Për partitë politike" në këto raste.

### b.Vlerësimi i dokumentacionit mbështetës të pasqyrave financiare

Në kërkim nga partia dokumentat mbështetës mbi të cilat janë hartuar pasqyrat financiare sipas funksionimit të cikleve dhe llogarive si: mjetet monetare / financimimet (statementet bankare dhe dokumentat arkës), blerjet / kreditorët (faturat e blerjes së mallrave dhe shërbimeve), aktivet afatgjata materiale (inventarin fizik dhe pasqyrat llogaritëse të amortizimit), pagat dhe sigurimet (listëpagesat, kontratat e punës), tatimet (deklarimet për tatimin në burim dhe TAP), si dhe dokumenta të tjerë kontabël, bazë dhe përmbledhës, lidhur me kontribute në natyrë, kontrata qerash etj.

Në i shqyrtuam dhe konkluzioni që arritem do paraqitet me rezerve.

### c.Kontrolli i elementeve të aktiveve dhe detyrimeve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar

#### Mjetet monetare

Nga auditimi i mjeteve monetare në banke dhe arke, verifikimi i gjendjeve në fillim të ushtrimit dhe levizjeve të ndodhura gjatë vitit rezultoi se gjendjet e tyre në fund të

ushtrimit te paraqitura ne aktivin e bilancit jane të rregullta. Ato konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventarin fizik të arkës ne fund te ushtrimit dhe paraqiten si vijon:

Llogaria bankare 16 820 leke dhe gjendja ne arke 1 025 leke.

#### Aktivët afatgjata materiale

Po ashtu u verifikuan dhe gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale nga ku rezultoi se nuk ka asnje aktive afatgjate te pasqyruar ne pasqyrat Financiare.

#### Të pagueshmet

Edhe nga verifikimet e gjendjeve dhe levizjeve te llogarive të pagueshme nuk ka te pasqyruar asnje detyrim ne pasqyrat financiare.

### III. TË ARDHURAT

#### A. PËRMBLEDHJE

		Sipas raportit vjeter	Sipas auditimit të kryer
<b>1. Financimi publik</b>			
	Shuma e granteve publike të marra	0 lekë	0 lekë
	Data e tranfertës (llogaria bankare ne BKT)		
<b>2. Donacionet private</b>			0
<b>3. Financimi nga burimet e vetë partisë</b>			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	0 lekë	0 lekë
<b>Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)</b>			
	Kuotat e anëtarësisë	0 lekë	0 lekë
	Botimet	-	-
	Shtypshkronja	-	-
	Marrje me qera	-	-
<b>Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)</b>			
	Kuotat e anëtarësisë (jane arketuar me arke nga degët)	lekë	lekë
	Botimet	-	-
	Shtypshkronja	-	-
	Marrje me qera	-	-
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe deklarimit bankar (shuma)	Nuk ka diferenca ne vlere midis deklarimeve bankare dhe pasqyrimi i tyre ne raportet financiare. Të ardhura nga grantet qeveritare jane teresisht me bank ndersa kuotat e antaresise jane me banke dhe arke.	
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe deklarimit bankar (data)	Të ardhura nga grantet qeveritare nuk jane arketuar ne vitin 2018.	
<b>4. Huatë/Kreditë</b>			

Shuma e përgjithshme e raportuar	0	0
Shuma / shuma e huasë / kreditë (për çdo kredi / hua)	-	-
Data e huasë / kreditë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)	-	-
Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua)	-	-
<b>5. Marrja e të ardhurave</b>		
Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë përkatëse.	Po	Nuk u kostatuan parregullsi

#### Kontributet e Specifikuara

Gjate viti 2018 te ardhurat ne pasqyrat financiare jane paraqitur 0 leke.

#### B. ANALIZA E BURIMEVE

##### a. Financimi nga burimet jo publike

###### Donatorët e lajuar

Në raportin vjetor të partisë nuk janë evidentuar të ardhura nga donacionet dhe po ashtu dhe nga procesi i auditimit.

###### Burimet e palejuara

Në raportin vjetor të partisë nuk janë evidentuar të ardhura nga burime të palejuara dhe po ashtu dhe nga procesi i auditimit.

###### Kontributet në natyrë

Në raportin vjetor të partisë nuk janë evidentuar të ardhura nga kontribute në natyrë dhe po ashtu dhe nga procesi i auditimit.

##### b. Financimi nga burimet e vetë partisë politike

###### Klasifikimi me zëra i të ardhurave nga burimet e vetë partisë

Nga burimet e partisë nuk është realizuar asnjë e ardhur gjate vitit 2018.

##### c. Huatë / Kreditë

Në raportin vjetor të partisë për vitin 2018 nuk janë evidentuar të ardhura nga huatë dhe kreditë dhe po ashtu dhe nga procesi i auditimit.

#### IV. SHPENZIMET

##### A. PËRMBLEDHJE SIPAS NATYRES

	Shpenzimet e deklaruar në raportin vjetor	Faturat e paraqitura	Dokumentet mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentat e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Shpenzimet e qerasë (Ambienta, sallat etj)	308,000	Fature Tatimore	Nuk u kostatuan mungesa	-	Nuk u kostatuan mosperputhje	308,000



<b>Shpenzime veprimt.</b>	<b>183,647</b>					<b>183,647</b>
OSHEE	9,967	Fature Tatimore	"		"	9,967
Uji	11,680	Fature Tatimore				11,680
Pagese auditi	162,000	Fature Tatimore	"		"	162,000
<b>Stafi/ rrogat</b>	<b>883,818</b>					<b>883,818</b>
Pagat	788,378	Listëpagesa	"		"	788,378
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	95,440	Listëpagesa	"		"	95,440
<b>Telefoni dhe Internet</b>	<b>333,595</b>	Fature Tatimore	"		"	<b>333,595</b>
<b>Komunikimet</b>						
Botimet			"		"	
Materialet promovuese			"		"	
Sondazhet e opinionit publik/Konferenca			"		"	
<b>Shpenzime udhëtimi,dieta, transporti</b>	<b>694,470</b>					<b>694,470</b>
Karburanti	226,900	Fature Tatimore				226,900
Honorar,evente koktejlle			"		"	
Pagesa per udhëtime	467,570	Fature Tatimore	"		"	467,570
<b>Shpenzimet bankare</b>	<b>9,800</b>	Nxjerrje bankare	"		"	<b>9,800</b>
<b>Administrative dhe të përgjithshme</b>						
Amortizim	0		"		"	0
Taksa vendore	39,400	Fature per arketim				39,400
<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>148,667</b>	Fature Tatimore				<b>148,667</b>
<b>SHUMA</b>	<b>2,601,397</b>					<b>2,601,397</b>

Strukturat vendore nuk kanë funksione administrimi në burimet dhe përdorimet e fondeve të partisë dhe për rrjedhim nuk ka evidencë ndarje shpenzimesh sipas degëve në qarqe.

## B. ANALIZA

### a.Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruarra dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë.

Te gjitha shpenzimet e kryera gjate ushtrimit 2018 janë të autorizuarra dhe të kontrolluarra nga nga qendra e partisë. Autorizimi i shpenzimeve, dokumentimi, regjistrimi, klasifikimi dhe raportimi behen nga qendra e shoqerise.Kjo ndodh sepse sipas organizimit te partisë deget në qarqe nuk kanë kopetenca pavarura që të përdorin fonde dhe të administrojne pasuri,gjithça eshte e perqendruar.

### b.Verifikimi

Si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve te vleresuara, si procedurë thelbesore u ndoq ajo e verifikimit të faturave origjinale të blerjes me pagesen e kryer dhe pasqyrimet e tyre llogaritë e blerjes (furnitorët) dhe të shpenzimeve sipas kategorive. Nga verifikimet e kryera me përzgjedhje nuk rezultoi ndonje parregullsi materiale.

Po ashtu u kërkua informacion për mallra dhe shërbime të marra në natyrë dhe sipas deklaratave të drejtimit nuk janë evidentuar shpenzime apo kontribute të kësaj natyre.

## **V. PËRFUNDIMI**

### **A. SINTEZA**

#### **a. Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve.**

Ne përfunduar procesin e auditimit bazuar në vlerësimin e rreziqeve të anomaliave materiale, më shumë evidence të mjaftueshme dhe të pershtatshme, përdorëm procedurat që gjykojmë të nevojshme dhe vërejtëm se Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut për vitin 2018 në KQZ-e nuk ka depozituar pasqyrat e pozicionit financiar por ka depozituar vetëm pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Në kushtet e mungesës së një minibilanci të strukturuar të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, ne nuk mund të gjykojmë për aktivet aftashkurtra, afatgjata dhe detyrimet e kësaj organizate.

Për sa i përket kërkesave specifike të ligjit nr. 8580, Datë 17.02.2000 "Për partitë politike" dhe udhëzimet e KQZ-së, si burimet e financimit, procedurat e marrjes së donacioneve jopublike, burimet e lejuara, kufizimet, dokumentimi dhe regjistrimi i tyre, identifikimi i dhuruesve, zbatim i rregullave të publikimit të tyre, etj, nuk u gjeten parregullsi dhe shkelje ligjore.

Në përfundim të auditimit, drejtimit të partisë ju komunikuan gjetjet, konkluzionet për çështjet e trajtuara dhe opinionin e audituesit mbi pasqyrat financiare.

#### **b. Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit.**

Ne vazhdim të çështjeve të shpjeguara më sipër gjatë procesit të auditimit nuk janë konstatuar gabime materiale, në pasqyrën e performancës, si dhe përjashtime të qëllimshme apo informacione të deformuara, por sic e theksova edhe më lart, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut nuk ka depozituar pasqyrat e pozicionit financiar por ka depozituar vetëm pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

## **B. PËRFUNDIMI**


### **I. Opinioni mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare 2018**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut e cila përfshinë vetëm pasqyrën pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve e cila sipas opinionit tonë paraqiten drejte ndërsa ne mungesë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe asaj të fluksit të parase opinionin ynë paraqitet me rezerve.

Në përfundim të verifikimeve dhe informacioneve të marra, kërkesave, kufizimeve dhe detyrimeve të kërkuara nga ligji nr. 8580, Datë 17.02.2000 "Për partitë politike" i ndryshuar dhe udhëzimeve të KQZ-së, për çështjet që gjejnë zbatim dhe aktivitetin e kryer për ushtrimin e vitit 2018, opinionin ynë është si vijon:

- Burimet e financimit te aktivitetit politik te Partise Bashkimi per te Drejta e Njeriut per periudhen raportuese 2018 ka ardhur nga perdorimi i gjendjes se mjeteve monetare te mbartura nga viti i kaluar.
- Nuk u evidentuan marrje te fondeve publike
- Nuk u evidentuan marrje te fondeve jopublike ne para apo ne natyre nga dhurues te identifikuar apo paidentifikuar.
- Nuk u evidentuan parregullsi dhe anomali materiale ne zbatim te kerkesave te legjislacionit kontabel dhe atij tatimor.

Eagjja "Xhevdet Nepravishata" Lushnje  
Cel: 069 40 98 121  
E-mail: eledadh@yahoo.it



## Pasqyra e Pozicionit Financiar 31.12.2018

(Shpenzimet të paraqitura sipas funksionit)

Nr	Pershkrimi i zert	Periudha 2018	Periudha 2017
	Ndryshimi në aktivet neto të pakufizuara:	2,619,242	1,331,480
	<b>Te ardhurat</b>		
	Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit	0	
	Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare	0	0
	Të ardhura nga grantet qeveritare apo nga agjenci të tjera të financimit	0	6,304,503
	Të ardhura nga investimet apo dhurimet	0	0
	Tarifat për shërbimet	0	0
	Të ardhura nga aktivitetet tregtare	0	0
	Të ardhura të tjera		
	<b>Totali I të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara</b>	<b>2,619,242</b>	<b>7,635,983</b>
	<b>Aktive neto të çliruara nga kufizimet:</b>		
	Aktive neto të çliruara nga kufizimet:	0	0
	Realizimi i kufizimeve të programit	0	0
	Realizimi i kufizimit për blerjen e pajisjeve	0	0
	Përfundimi i kufizimit të afatit	0	0
	<b>Totali I aktiveve neto të çliruara nga kufizimet</b>		
	<b>Totali I të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara:</b>		
	<b>Shpenzime për aktivitetet</b>		
	Shpenzime per personellin	700,000	1,495,000
	Shpenzime per utilitete	860,707	1,041,470
	Shpenzime te tjera	1,040,690	2,480,271
	Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme		
	Krijim dhe ritje fondesh		
	<b>Totali I shpenzimeve</b>	<b>2,601,397</b>	<b>5,016,741</b>
	<b>Rritja/Rënia në aktivet neto të pakufizuara (A)</b>	<b>-2,601,397</b>	<b>-5,016,741</b>
	<b>Ndryshimi në aktivet neto të kufizuara:</b>		
	Kontributet		
	Të ardhurat nga Investimet afat gjata		
	Fitimi i realizuar dhe i porealizuar nga Investimet afatgjata		
	Humbja aktuariale nga obligacioni vjetor		
	Aktivete neto të çliruara nga kufizimet (me shenjë minus)		
	<b>Rritja/Rënia në aktivet neto përkohësisht të kufizuara (B)</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>Ndryshimi në aktivet neto (A + B)</b>	<b>-2,601,397</b>	<b>-5,016,741</b>
	Aktive neto në fillim të vitit	2,619,242	7,635,983
	Aktive neto në fund të vitit	17,845	2,619,242

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**PARTIA BASHKIMI PER TE DREJTAT E NJERIUT**

**DEKLARATE**

Pasi u njohem me vendimin e Komisionit Qendror te Zgjedhjeve Nr. 112 DATA 27.03.2019 per Auditimin e Fondeve te Perfituara dhe Shpenzuara nga Subjektet Zgjedhore per vitin 2018.

**DEKLAROJ**

Une kryetari i Partise Bashkimi per te Drejtat e Njeriut, Vangjel Dule, ne zbatim te dispozites ligjore te Ligjit 10019 date 29/12/2008 i ndryshuar "Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise", Ligjit nr 8580 date 17.02.2000 "Per Partite Politike" i ndryshuar deklaroj se nuk kam marre kontribute sponsorizimi, dhurimi e te tjera siç parashikohet nga Ligji i mesiperm.

Kryetari i Partise Bashkimi per te Drejtat e Njeriut deklarom se ka keto te ardhura dhe shpenzime per vitin 2018 paraqiten si me poshte :

**Te Ardhurat**

Nr	Burimet e perfitimit te fondeve gjate vitit 2018	Vendi i depoziti mit	Lloji i monedhes			Kur si	Total ne leke
			Leke	Us d	Nc natyre		
I	Buxheti i shtetit	Banke	0				0
II	Burimet e veta						
III	Sponsorizimet						
	Sponsorizime						
	Sponsorizime						
IV	Te ardhura nga anctaret						
V	Interesa bankare		0				0
VI	Te tjera						
	<b>Totali</b>		<b>0</b>				<b>0</b>



## Shpenzimet

N r	Emertimi i shpenzimeve	Shenime	Menyra e kryerjes se pageses	Totali i shpenzimeve
1	Paga dhe sigurime shoqerore			700.000
2	Kancelari dhe te ngjashme			73.800
3	Marrje salla me qera			315.290
4	Pagese auditimi			162.000
5	Shpenzime noteriale			4.500
6	Pagesa per udhetime			467.570
7	Shpenzime gjyqesore			0
8	Shpenzime karburant			0
9	Shpenzime per utilitete			860.707
10	Te tjera			17.530
	<b>Totali</b>			<b>2.601.397</b>

Gjendja e mjeteve te tepruara nga viti 2018 eshte ne shumen 17845 leke e cila eshte e njejte me gjendjen e llogarise bankare.

Kete Deklarate ja paraqesim Auditueses Fleda Dhima, e cila eshte caktuar te kryej auditimin e fondeve te perftuara dhe shpenzuara nga Partia Bashkimi per te Drejtat e Njeriut per aktivitetin e subjektit per vitin 2018.

Kryetari i PBDNJ

Tirane 18.05.2019



INSITUTI I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR  
Eleda Dhima AUDITUESE LIGJORE  
Licenca profesionale  
Nr.197, date 30.01.2009

## LETET ANGAZHIMI AUDITIMI

Zotit Vangjel Dule

Kryetar i Partise Bashkimi per te Drejtat e Njeriut

Me vendim te KQZ, Nr.112 date 27.03.2019 "Per shpalljen e rezultatit te shortit per emerimin e eksperteve kontabel te licensuar, te cilet do te kryejne auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga partite politike per vitin kalendarik 2018", une Eleda Dhima, me license Nr. 197 date 30.01.2009 e nipt K93819401P jam caktuar Audituese Ligjore per Auditimin e Fondeve te Perfituara dhe te Shpenzuara ne Partine Bashkimi per te Drejtat e Njeriut.

Kam kenaqesine qe me anen e kesaj letre t'ju konfirmoj se e kam pranuar kete angazhim. Mbi kete baze me KQZ-ne lidha Kontraten e Sherblimit te Auditimi Nr. nr 1466/1 date 26.04.2019.

Angazhimi do te kete per objektiv te shpreh nje opinion mbi sinqeritetin, vertetesine dhe rregullshmerin e Fondeve te Perfituara dhe te Shpenzuara nga subjekti juaj gjate vitit 2018.

Auditimin do ta kryejme ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarde kerkojne qe ne te zbatojme kerkesat etiko dhe te planifikojme e kryejme auditimin per te mare siguri te arsyeshme nese Pasqyrat Financiare per Fondet e Perfituara dhe te Shpenzuara, jane pa anomali materiale. Auditimi perfshin shqyrtimin mbi bazen e testeve, dokumentave dhe evidencave qe mbeshtesin shumat dhe informacionet ne Pasqyrat Financiare gjithperفشirese te hartuara per kete qellim. Auditimi perfshin gjithashtu vleresimin e pershtatshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe llogjiken e cmuarjeve kontabel te bere nga Drejtimi, si edhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te ketyre Pasqyrave Financiare.

Ne borjen e ketyre vleresimeve te rrezikut, ne do te vleresojme kontrollin e brendshem qe ka te beje me pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te Pasqyrave Financiare ne menyre qe te percaktojme ato procedura te auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat, por jo per qellimin e shprehjes se opinionit ne lidhje me efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit.

Ne zbatim te kerkesave te Standarteve Kontabilitetit dhe Auditimit, pergjegjesia per pergatitjen e Pasqyrave Financiare gjithperفشirese per Fondet e Perfituara dhe te Shpenzuara eshte e Drejtimit te Partise. Kjo perfshin mbajtjen e regjistrimeve te duhura kontabel dhe zbatimin e parimeve kontabel. Si pjese perberese e procesit te auditimit ne kerkojme nga drejtimi qe te marrim prej tij konfirmimin me shkrim lidhur me paraqitjet qe do te na behen ne lidhje me kete proces auditimi.

Raporti i Auditimit te Fondeve te Perfituara dhe te Shpenzuara qe do te hartohet ne perfundim te auditimit, se bashku me Shenimet Shpjeguese qe mbeshtesin kete raport, do ti jepet KQZ-se dhe nje kopje Partise Bashkimi per te Drejtat e Njeriut.



Shpresojme te kemi bashkepunim te plote me stafin tuaj dhe besojme se ata do te na vendosin ne dispozicion regjistrat, dokumentacionin dhe informacionin tjeter qe kerkohet per kryerjen e auditimit.

Ju lutemi te shprehni mendimin duke iu pergjigjur kesaj Letre Angazhimi per te treguar se eshte ne perputhje me kuptimin e juaj per marrveshjen e lidhur me KQZ-ne per Auditimin e Fondeve te Perfituara dhe te Shpenzuara gjate vitit 2018 nga Partia Bashkimi per te Drejtat e Njeriut.  
Duke Ju Falenderuar per Bashkpunimin

Audituesc Lajfore

Eleda Dhima



Tirane, me 21.05.2019

Pranuar ne emer te Partise Bashkimi per te Drejtat e Njeriut

Kryetari

Vangjel Dule

Tirane me 21.05.2019

